

Sfidat dhe potenciali i Kompleksit Multisportiv apo Palestrës së re në Prizren





Sfidat dhe potenciali i Kompleksit Multisportiv në Prizren

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr. 67, Prizren,
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org

029 222 771

PËRMBAJTJA

1

Hyrje

2

Projekti për ndërtimin e Kompleksit
Multisportiv në Prizren

3

Gjetjet nga anketa me qytetarët e
Prizrenit

4

Buxheti dhe perspektiva afatshkurtër

5

Përfundime dhe rekomandime

6

PËR EC-IN

HYRJE

Ndërtimi i objekteve të reja sportive nuk është thjesht një çështje e infrastrukturës fizike, por një domosdoshmëri shoqërore dhe zhvillimore për komunitetet urbane. Kompleksiteti i jetës moderne, urbanizimi në rritje dhe sfidat e shëndetit publik kanë sjellë nevojën për qasje të integruar ndaj sportit dhe aktiviteteve fizike. Në këtë kontekst, komplekset multisportive apo palestrat sportive luajnë një rol kyç si qendra gjithëpërfshirëse për shëndetin, edukimin fizik, zhvillimin e talenteve sportive dhe përfshirjen sociale.

Nëse rritet numri dhe cilësia e objekteve sportive, do të rritet në të njëjtën masë edhe interesi i njerëzve për aktivitetet sportive. Por gjëja më e rëndësishme është ndërtimi i objekteve që janë cilësore dhe që shoqëria mund t'i pranojë dhe t'i përdorë me lehtësi.*

Objekte të tilla nuk i shërbejnë vetëm sportistëve profesionistë, por gjithë spektrit të qytetarëve: të rinjve, nxënësve, familjeve, grave, të moshuarve, si dhe personave me aftësi të kufizuara. Ato janë hapësira për rritjen e mirëqenies fizike dhe mendore, për parandalimin e sëmundjeve, për promovimin e barazisë gjinore dhe për krijimin e komuniteteve më të lidhura dhe aktive.

Zhvillimi i infrastrukturës sportive në komunitet nxit përfshirjen, kohezionin shoqëror dhe ndjenjën e identitetit, si dhe mund të sjellë përfitime të mëdha ekonomike.**

Prandaj secili projekt i kësaj natyre kërkon që të ndërtohet duke u nisur nga nevojat reale të përdoruesve të tij, komuniteti lokal. Kjo nuk është vetëm një çështje teknike, por një domosdoshmëri demokratike dhe sociale. Përfshirja e qytetarëve në fazat e planifikimit dhe dizajnit garanton që projekti final të jetë funksional, gjithëpërfshirës dhe i përqafuar nga publiku. Për më tepër, kjo qasje ndihmon në shmangien e vendimmarrjeve të centralizuara që mund të çojnë në vendosjen e objekteve në zona jo të përshtatshme apo në ndërtimin e strukturave që nuk reflektojnë realisht kërkesën në terren.

* Integral Spor, "Why Municipalities Should Establish Sports Facilities?", artikull, linku: <https://integralspor.com/news/why-municipalities-should-establish-sports-facilities>

** Stantec, "Building a legacy: Designing sports facilities that serve communities for decades", artikull, linku <https://www.stantec.com/en/ideas/topic/buildings/building-a-legacy-designing-sports-facilities-that-serve-communities-for-decades>

Planifikimi nga lart-poshtë, pa konsultim me qytetarët dhe akterët lokalë, ka prodhuar jo rrallëherë ndërtesa bosh, jo të shfrytëzuara, që përfaqësojnë keqmenaxhim të burimeve publike. Prandaj, ndërtimi i një kompleksi multisportiv apo palestre sportive në Prizren duhet të jetë rezultat i një procesi të hapur, bashkëpunues dhe të bazuar në të dhëna e dëshmi konkrete.

Projekti për ndërtimin e objektit të ri sportiv në Prizren

Në lidhje me projektin për ndërtimin e Kompleksit Multisportiv apo një Palestre të re sportive në Prizren, situata aktuale nuk karakterizohet nga transparenca e dëshiruar. Sipas një përgjigjeje zyrtare nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Prizrenit, kjo drejtori nuk ka pasur asnjë komunikim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) lidhur me këtë projekt.*** Po ashtu, nuk ka pasur ndonjë adresim nga MKRS për të përfshirë komunën në procesin e planifikimit apo bashkëfinancimit të objektit sportiv si palestër me disa hapësira.

Ky boshllëk në komunikim ndërinstitutional përbën një shqetësim serioz, pasi projektet kapitale që ndikojnë në infrastrukturën urbane dhe shërbimet publike kërkojnë domosdoshmërisht koordinim të ngushtë mes nivelit qendror dhe atij lokal.

Ndërkohë, në skenën politike dhe institucionale lokale ka pasur mospajtime lidhur me vendndodhjen e mundshme të kompleksit. Para tre muajsh, anëtari i Kuvendit Komunal të Prizrenit, Ilir Gashi, kundërshtoi idenë e menaxhmentit komunal për ndërtimin e një palestre në oborrin e shkollës fillore “Abdyl Frashëri” në lagjen Ortakoll, duke e cilësuar si ngufatje urbane që bie ndesh me premtimin e kryetarit Shaqir Totaj për më shumë hapësira të gjelbra. Ndërkohë, vetë kryetari Totaj ka konfirmuar përmes një takimi me Federatën e Basketbollit të Kosovës se projekti i palestrës sportive në Ortakoll po ecën drejt finalizimit. ****

*** DKRS përgjigje me email, prill 2025.

**** Telegrafi.com, Kuvendari i LVV-së kundërshton idenë e Komunës së Prizrenit për ndërtimin e palestrës sportive në oborrin e shkollës, artikull, linku: <https://telegrafi.com/kuvendari-lvv-se-kundershton-idene-e-komunes-se-prizrenit-per-ndertimin-e-palestres-sportive-ne-oborrin-e-shkolles/>

Gjetjet nga anketa me qytetarët e Prizrenit

Sipas anketës***** së zhvilluar nga EC Ma Ndryshe, pjesëmarrja në sport rezulton të jetë një aktivitet mjaft i përhapur mes qytetarëve të Prizrenit. 63% e të anketuarve ushtrojnë sport herë pas here, ndërsa 18% janë aktivë në mënyrë të rregullt. Vetëm 19% nuk merren fare me sport. Kjo tregon një kërkesë të qëndrueshme për hapësira të përshtatshme dhe të qasshme për aktivitete fizike.

Sporti më i praktikuar është futbolli (35%), i ndjekur nga fitnesi dhe palestra (22%). Më pas vijnë basketbolli (11%), volejbolli (6%) dhe noti (4%), ndërsa sportet e tjera kanë përqindje më të vogla.


Kur pyeten për infrastrukturën ekzistuese, 73% e qytetarëve e konsiderojnë atë si të pamjaftueshme, vetëm 19% e konsiderojnë të mjaftueshme, ndërsa pjesa tjetër nuk ka informacion apo e vlerëson si të papërshtatshme.

Sa i përket vendndodhjes së mundshme për palestrën e re, lagjja Ortakoll rezulton më e preferuara me 27% të përkrahjes, e ndjekur nga Bazhderhanja (17%) dhe Jeta e Re (11%). Qendra e qytetit përmendet nga 9% e të anketuarve, ndërsa pjesa tjetër propozon zona të tjera me përqindje më të ulëta.


Kriteret kryesore për përzgjedhjen e lokacionit janë: hapësira e bollshme dhe mundësitë për parkim (44%), qasja e lehtë me transport publik (42%), mungesa e infrastrukturës sportive në atë zonë (33%) dhe afërsia me shkollat apo universitetin (25%).

Përveç vendndodhjes, qytetarët e anketuar theksojnë edhe tiparet që duhet të ketë palestra e re: ajo duhet të jetë lehtësisht e qasshme me autobus (82%) dhe afër vendbanimit të tyre (79%). Gjithashtu, 91% vlerësojnë që ajo duhet të jetë e përshtatshme për aktivitete të ndryshme sportive dhe 90% kërkojnë që të jetë e përshtatshme për të gjitha grupmoshat. Po ashtu, 87% e konsiderojnë të rëndësishme përfshirjen e standardeve për personat me aftësi të kufizuara.


A jeni aktiv/e në ndonjë aktivitet sportiv?




Nëse po, cilat sporte praktikon më shpesh?



A janë të mjaftueshme hapësirat ekzistuese sportive në Prizren?



Në cilën zonë të qytetit mendoni se do të ishte më e përshtatshme ndërtimi i palestrës së re?



Cilat janë arsyet që e bëjnë këtë lokacion të përshtatshëm? (Mund të zgjedhësh më shumë se një opsion)

Afërsia me qendrat shkollore/universitare

25.2%

Qasja e lehtë me transport publik

42.4%

Hapësira e bollshme dhe mundësi parkimi

44.4%

Ka mungesë të infrastrukturës sportive në atë zonë

33.1%

**Sa e rëndësishme është për ju që palestra të jetë:
(Janë te përfshira 5 pyetje të ndryshme të vlerësuara nga 1 deri në 5; rezultatet janë zbërthyer dhe paraqitur në përqindje)**

Afër shtëpisë tuaj

79.4%

Lehtësisht e qasshme me autobus

81.8%

E përshtatshme për të gjitha grupmoshat

90.4%

E përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara

87.2%

Me mundësi për aktivitete të ndryshme sportive


91.2%

Buxheti dhe perspektiva afatshkurtër

Në buxhetin e Kosovës për vitin 2025 janë ndarë 600,000 euro për ndërtimin e komplekseve multisportive në disa rajone përfshirë edhe Prizrenin. Për vitin 2026 parashihen 2,450,000 euro dhe për vitin 2027 edhe 3,000,000 euro, me një total prej 6,050,000 euro.***** Megjithatë, nuk është e qartë se sa nga këto mjete janë të dedikuara specifikisht për Prizrenin, dhe as se në çfarë faze ndodhet projekti për këtë qytet. Gjithashtu nuk ka sqarime se a është ky projekt që ndërlidhet me palestrën e re sportive të promovuar nga autoritetet lokale. Pra ka ende paqartësi për publikun. Mungesa e informacioneve publike dhe e transparencës rreth projektit ose projekteve lë shumë paqartësi për qytetarët dhe shoqërinë civile.

Buxheti për Komplekse Multisportive në Kosovë (2025-2027):

Viti	Buxheti i ndarë (€)
2025	600,000€
2026	2,450,000€
2027	3,000,000€
Totali	6.050,000€



***** Ligji mbi ndarjet buxhetore 2025, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=99639>

Përfundime dhe rekomandime

Ndërtimi i një kompleksi multisportiv ose palestretë re sportive në Prizren është një mundësi e rëndësishme për të avancuar mirëqenien fizike dhe shoqërore të qytetarëve. Por kjo mundësi rrezikon të humbasë kuptimin dhe mbështetjen publike nëse procesi zhvillohet në mënyrë të mbyllur, pa konsultim dhe pa koordinim institucional.

Rruga drejt një infrastrukture moderne sportive kalon përmes përfshirjes së komunitetit, planifikimit të kujdesshëm dhe vizionit të përbashkët për një Prizren më aktiv, më të shëndetshëm dhe më gjithëpërfshirës.

Rekomandimet:

Publikimi i të dhënave – MKRS duhet të publikojë të dhëna të qarta rreth projektit për Prizrenin, përfshirë planifikimin buxhetor, fazat e ndërtimit, lokacionin e propozuar dhe dokumentet teknike ekzistuese.

Konsultimi me qytetarët – Komuna dhe ministria duhet të organizojnë konsultime publike për të dëgjuar mendimin e komunitetit, të rinjve, sportistëve dhe grupeve të tjera të interesuara.

Vlerësimi i lokacionit – Për të shmangur vendime të njëanshme, duhet analizuar me kujdes çdo lokacion i mundshëm përmes një studimi shumë-kriterësh që përfshin ndikimin urban, ekologjik dhe social.

Projektim gjithëpërfshirës dhe funksional – Kompleksi duhet të jetë i qasshëm për të gjitha grupmoshat dhe aftësitë, të ofrojë hapësira për më shumë se një sport, dhe të ketë hapësira ndihmëse si garderoba, ambiente për trajnim, zona pushimi, etj.

Koordinim ndërinstitutional – MKRS dhe Komuna duhet të krijojnë një grup pune të përbashkët për të udhëhequr projektin dhe për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në çdo fazë.

Për EC:

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse.

Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar.

Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-it synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

Deklarata e vizionit

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

Deklarata e misionit

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.